









REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



<b>DATË:</b>	09 tetor 2020
<b>PËR:</b>	KPF-në dhe KK-në
<b>PROPOZUES:</b>	<i>për</i> Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës 
<b>HARTUES:</b>	Komisioni në këtë përbërje: Remzije Zekolli, kryesuese  Fitore Hyseni, anëtare  Kadrije Meniqi, anëtare  Qemail Hasani, anëtar  Albanez Tahiraj, anëtar 
<b>LËNDA:</b>	AKT PËRCJELLËS

Të nderuar,

Bashkëngjitur me këtë akt përcjellës ua dërgojmë për shqyrtim dhe aprovim Draft-Rregulloren për realizimin e të drejtave, përkujdesjen, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë, (shqyrtimi i parë)

Me respekt!

Bazuar në Konventën Mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 14 i Ligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, dhe nenin 11, nenin 12, paragrafin 12.2, pika (c) dhe nenin 17, pika (s) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit, 41 paragrafi 2 Shkronja (c) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_ 2020, aprovoi këtë:

## **RREGULLORE**

### **PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE, PËRKUJDESJEN, MBROJTJEN DHE PARANDALIMIN E PUNËVE TË RËNDA PËR FËMIJË**

#### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i masave për realizimin e të drejtave, përkujdesjen dhe mbrojtjen e fëmijëve. Gjithashtu kjo rregullore ka për qëllim eliminimin e punëve të rënda për fëmijë, si dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të subjekteve për mbrojtjen e fëmijëve duke i përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta në Komunën e Vushtrrisë.

#### **Neni 2 Fushëveprimtaria**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen vetëm për kategorinë e fëmijëve, të cilët jetojnë dhe veprojnë në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

#### **Neni 3 Përkufizimet**

Në këtë rregullore termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. **“Fëmijë”** nënkupton çdo person nga momenti i lindjes deri në moshën 18 vjeç.
2. **“Fëmija në rrezik”** nënkupton fëmijën, të cilit i mohohen ose i cenohen të drejtat e parashikuara me këtë rregullore.
3. **“Mbrojtja e fëmijës”** nënkupton parandalimin e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit, punën e rëndë të fëmijëve dhe praktikën e dëmshme tradicionale (martesat e hershme).
4. **“Punë e rrezikshme për fëmijë”**, nënkupton punën që mund të rezultojë me vdekje, lëndime të lehta dhe të rënda dhe dëmtim të organeve vitale.
5. **“Punë e detyruar”** nënkupton punën ose shërbimet të cilat kërkohen nga fëmija, nën kërcënimin me ndëshkim, përkundër vullnetit të tij.
6. **“Punë e rëndë”**, nënkupton çdo punë fizike e cila dëmton shëndetin e fëmijës, rrezikon dëmtimin e organeve vitale dhe jetën e fëmijëve.
7. **“Punë e lejuar për fëmijë”**, nënkupton pjesëmarrjen e fëmijëve në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme dhe të rrezikshme për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijës.

8. **“Kujdesi alternativ”** nënkupton konceptin e qasjes familjare për përkujdesje afatshkurtër dhe afatgjatë të fëmijëve të braktisur dhe fëmijëve që kanë humbur kujdesin prindëror.
9. **“Mekanizmi koordinues”** nënkupton mekanizmin koordinues komunal i cili vendos prioritetet dhe koordinon punën dhe aktivitetet me organet kompetente të komunës për zbatimin e kësaj rregulloreje.
10. **QKMF**- nënkupton Qendrën kryesore të mjekësisë familjare.
11. **QMF**- nënkupton Qendrën e mjekësisë familjare.
12. **AMF**- nënkupton ambulatat e mjekësisë familjare.

#### **Neni 4**

#### **Parimet e përgjithshme për të drejtat e fëmijës**

1. Dispozitat e kësaj rregulloreje bazohen në parimet e Konventës Mbi të Drejtat e Fëmijës, të cilat të janë:
  - 1.1. **Mosdiskrimini** - nënkupton se të gjithë fëmijët brenda legjislacionit në fuqi i gëzojnë të drejtat e barabarta pavarësisht racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, përkatësisë etnike, sociale, statusit ekonomik të fëmijës, prindërve apo kujdestarit ligjor;
  - 1.2. **Interesat optimale të fëmijës** - nënkuptojnë situatat në të cilat institucionet në prioritet marrin në konsideratë interesat më të mira të fëmijëve;
  - 1.3. **E drejta e jetesës dhe zhvillimit** - nënkupton sigurimin e një jete sa më cilësore për fëmijët, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe në atë mendor, emocional, social, kulturor dhe institucional;
  - 1.4. **Pikëpamjet e fëmijës** - nënkuptojnë lirinë e fëmijëve për t'i shprehur mendimet e tyre mbi çështjet që lidhen me ta, si dhe obligimin e institucioneve për t'i dëgjuar këto mendime dhe për t'i marrë parasysh, gjithmonë në përputhje me nivelin e zhvillimit të fëmijëve.

#### **Neni 5**

#### **Obligimet e komunës lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve**

1. Institucionet e Komunës së Vushtrrisë janë të angazhuara për zbatimin e plotë të Konventës lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve;
2. Institucionet e komunës i garantojnë secilit fëmijë hapësirë të mjaftueshme për të:
  - 2.1. Kontribuar lidhur me vendimet e komunës, të cilat trajtojnë çështjet e fëmijëve;
  - 2.2. Siguruar pjesëmarrjen në komunitet dhe në jetën sociale;
  - 2.3. Mundësuar shërbime kryesore siç janë: kujdesi shëndetësor primar, arsimimi dhe kujdesi alternativ;
  - 2.4. Mundësuar organizimin e seminareve që trajtojnë aspektet e higjienës së domosdoshme personale dhe mjedisit të pastërt;
  - 2.5. Ofruar mbrojtje nga shtrytëzimi, dhuna, abuzimi, punët e rënda dhe të rrezikshme;
  - 2.6. Siguruar hapësira rekreative për aktivitete të ndryshme;
  - 2.7. Siguruar pjesëmarrje në ngjarjet kulturore dhe sportive;
  - 2.8. Mundësuar qasje në çdo shërbim të nevojshëm për realizimin e të drejtave të tyre.

## **Neni 6**

### **Përgjegjësitë për realizimin e të drejtave të fëmijëve**

1. Realizimi i të drejtave të fëmijëve është përgjegjësi kryesore e familjes dhe institucioneve lokale.
2. Institucionet komunale, të cilat janë kompetente në fushën e të drejtave të fëmijëve, kanë përgjegjësi ligjore dhe sociale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe parandalimin dhe eliminimin e punëve të rënda dhe të rrezikshme.
3. Fëmijët i gëzojnë të gjitha të drejtat ashtu siç janë përcaktuar sipas Konventes Mbi të Drejtat e Fëmijës.
4. Fëmijët janë kategori e veçantë e personave, të cilët për shkak të moshës, zhvillimit fizik, intelektual dhe pjekurisë duhet t'i realizojnë të drejtat e tyre me mbështetjen e të rriturve.
5. Prindërit, familjet, kujdestarët dhe institucionet e qeverisjes lokale mbajnë përgjegjësi për realizimin e të drejtave të fëmijëve, për të siguruar ruajtje dhe kujdes të veçantë.
6. Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës në komunë janë:
  - 6.1. Kuvendi i Komunës;
  - 6.2. Kryetari i Komunës;
  - 6.3. Drejtoria për Arsim;
  - 6.4. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale;
  - 6.5. Zyra për të drejtat e njeriut në komunë;
  - 6.6. Qendra për Punë Sociale, institucionet e drejtësisë;
  - 6.7. Institucionet shëndetësore QKMF, QMF, AMF;
  - 6.8. Këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane;
  - 6.9. Këshilli lokal i prindërve.

## **Neni 7**

### **Masat e përgjithshme për mbrojtjen e fëmijës**

1. Masat e përgjithshme për mbrojtjen e fëmijës janë:
  - 1.1. Parandalimi;
  - 1.2. Masat e mbrojtjes ligjore;
  - 1.3. Detyrimi Ligjor për raportim;
  - 1.4. Ndarja e fëmijës nga familja;
  - 1.5. Mbrojtja e fëmijës pa përkujdesje prindërore;
  - 1.6. Mbrojtja e fëmijës gjatë qëndrimit në strehim familjar;
  - 1.7. Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës;
  - 1.8. Monitorimi i masave të mbrojtjes dhe
  - 1.9. Masat për aftësim prindëror.

## **Neni 8**

### **Format specifike të mbrojtjes së fëmijës**

1. Format specifike të mbrojtjes së fëmijës janë:
  - 1.1 Mbrojtja e fëmijës nga pornografia;
  - 1.2 Masat kundër faqeve të internetit me përmbajtje pornografike dhe të atyre që dëmtojnë shëndetin dhe jetën e fëmijës;
  - 1.3 Kapaciteti i fëmijës për të ndërmarë veprime ligjore;
  - 1.4 Drejtësia mike ndaj fëmijës;
  - 1.5 Ndhurma juridike dhe qasja në organet e drejtësisë;
  - 1.6 Ndhurma mjeksore dhe psikologjike, rehabilitimi dhe masat për riintegrim;
  - 1.7 Personat e dënuar për abuzim seksual apo shfrytëzim të fëmijës ;
  - 1.8 Pjesëmarrja e fëmijës në konfliktin e armatosur;
  - 1.9 Mbrojtja e fëmijës të prekuar nga konflikti i armatosur dhe mbrojtja e fëmijës së zhvendosur brenda shtetit.

## **Neni 9**

### **Punët dhe aktivitetet e ndaluara për fëmijë**

1. Me qëllim të parandalimit të rrezikimit dhe ruajtjes së shëndetit të fëmijëve, ndalohen këto lloje të punëve:
  - 1.1 Puna e natës për fëmijë, nga ora 20:00-06:00;
  - 1.2 Ngritja dhe bartja e peshave të rënda mbi 15 kg për meshkuj dhe mbi 10 kg për femra;
  - 1.3 Puna e fëmijës që kërkon ekuilibër të veçantë;
  - 1.4 Puna e fëmijës në sipërfaqe të tokës, nën ujë, në vendet e mbyllura dhe lartësi mbi 2m;
  - 1.5 Puna e fëmijës që shkakton dëme në shëndetin e tyre për shkak të ekspozimit ndaj temperaturave të larta apo të ulëta, ose ndaj zhurmës dhe dridhjes;
  - 1.6 Puna e fëmijës që përfshin, ekspozim ndaj substancave biologjike, kimike, fizike dhe toksike, të cilat paraqesin rrezik për shëndetin e tyre, si dhe puna e fëmijëve që i ekspozohet radioaktivitetit;
  - 1.7 Puna e fëmijës në sektorin e bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë ku përfshihen operimi me makina bujqësore, spërkatja me pesticide, punë të rënda fizike në fusha, prerja e drunjve dhe puna në thertore, therja, bartja dhe shitja e kafshëve;
  - 1.8 Punët në rrugë ku përfshihen: bartja e mallvare, ngritja hidraulike e mjeteve motorike, bartja e mallrave me karrocë, kërkim-lëmosha;
  - 1.9 Puna e fëmijëve në gjermimin, grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave;
  - 1.10 Puna e fëmijës në eksportimin e pasurive natyrore;
  - 1.11 Fëmija nën moshën 18 vjeç nuk mund të punoj punë të rrezikshme.
2. Aktivitete e ndaluara për fëmijë janë:
  - 2.1. Frekuentimi i fëmijës në klubet e natës;
  - 2.2 Frekuentimi në lokalet e lojërave të fatit;
  - 2.3 Qasja në lojërat e fatit online;
  - 2.4 Frekuentimi në qendrat argëtuese për të rritur dhe të ngjajshme;

3. Organi Komunal obligohet që t'ia paraqes kërkesën me shkrim operatorit të ndonjë ngjarjeje publike për të kufizuar qasjen për fëmijët nën moshën 18 vjeçare.

### **Neni 10** **Monitorimi i punëve për fëmijë**

Me qëllim të monitorimit të punëve të fëmijëve, mekanizmi koodrinues bën: identifikimin, vlerësimin, tërheqjen, mbrojtjen, prarandalimin, verifikimin dhe përcjelljen, në mënyrë që të parandalohen dhe eliminohen punët e rënda të fëmijëve konform kësaj rregulloreje.

### **Neni 11** **Puna dhe angazhimi përjashtimisht i lejuar**

1. Secila punë e fëmijës e paguar, punë vullnetare, punë si pjesë e praktikës profesionale apo çdo lloj angazhimi tjetër i fëmijës mund të lejohet vetëm nën mbikëqyrjen e rregullt dhe pasi që të evidentohen të gjitha rreziqet potenciale, si dhe të jenë të planifikuara masat për kontrollimin e rreziqeve të mundshme të cilave mund t'u ekspozohet fëmija.
2. Mardhënja e punës mund të themelohet (lidhë kontratë pune) me fëmijën nga 15 vjeç deri në 18 vjeç;
3. Në rastet sipas paragrafit 2 fëmijët mund të punësohen vetëm në aktivitete ekonomike që nuk janë të dëmshme për zhvillimin dhe shëndetin e tyre, veçanërisht nuk pengojnë që të vijojnë shkollimin dhe shfrytëzimin e kohës së tyre të lirë.

### **Neni 12**

#### **Mekanizmi koordinues për realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda**

1. Kryetari i komunës me vendim themelon mekanizmin koordinues për mbrojtjen nga punët e rënda dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve.
2. Mekanizmi koordinues vendos prioritetet dhe sistemet e sigurimit të cilësisë për formësimin e çështjeve dhe zgjidhjeve për fëmijë, duke përfshirë edhe planifikimin buxhetor për implementimin e planit të veprimit.
3. Mekanizmi koordinues përbëhet nga përfaqësues të institucioneve komunale siç janë:
  - 3.1 Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, i cili është edhe udhëheqës i këtij mekanizmi;
  - 3.2 Drejtori i Drejtorisë për Arsim;
  - 3.3 Koordinatori i njësisë komunale për të drejtat e njeriut;
4. Mekanizmi koordinues ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 4.1. Siguron koordinimin e politikave, të cilat ndikojnë te fëmijët;
  - 4.2. Angazhohet që aktet nënligjore të nivelit lokal t'i promovojnë të drejtat e fëmijëve;
  - 4.3. Kryen vetëvlerësime periodike, të cilat rezultojnë me veprime dhe politika konkrete dhe të cilat duhet të implemetohen nga institucionet komunale;

- 4.4. Në baza periodike udhëheq procesin e hartimit të strategjisë komunale dhe planit të veprimit për fëmijë, si dhe përcjellë zbatimin e tij;
- 4.5. Bën rekomandime lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve;
5. Strategjia komunale dhe plani i veprimit për të drejtat e fëmijëve miratohen në Kuvendin e komunës.
6. Mekanizmi koordinues i përcakton treguesit dhe të dhënat që janë prioritete të komunës për fëmijët dhe interesat e tyre.

### **Neni 13**

#### **Qeverisja lokale dhe të drejtat e fëmijëve**

1. Komuna bën vlerësimin e ndikimit të politikave, strategjive, planeve të veprimit dhe programeve për të drejtat e fëmijëve.
2. Mekanizmi koordinues kryen vlerësime të rregullta lidhur me ndikimin e qeverisjes lokale për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

### **Neni 14**

#### **Raportimi lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve**

1. Kryesuesi i mekanizmit koordinues i raporton Kuvendit të Komunës për punën dhe funksionimin e mekanizmit koordinues.
2. Raportimi si në paragrafin 1 të këtij neni realizohet në baza periodike.
3. Komuna i shfrytëzon raportet në mënyrë efektive për të zhvilluar politika, strategji komunale, plane të veprimit dhe buxhetim për të drejtat e fëmijëve.

### **Neni 15**

#### **Buxhetimi për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin nga punët e rënda**

Kuvendi i Komunës në baza periodike ndan mjete financiare (buxhetim) për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve që i dedikohen fëmijëve.

### **Neni 16**

#### **Promovimi i të drejtave të fëmijëve**

1. Komuna përmes mekanizmit koordinues ndërmerri masa konkrete për promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve, si dhe mbrojtjen e tyre nga punët e rënda dhe të rrezikshme.
2. Masat për promovimin e të drejtave të fëmijëve realizohen përmes organizmit të trajnimeve dhe tryezave mbi të drejtat e fëmijëve, për udhëheqësit dhe zyrtarët kompetent të komunës.
3. Me qëllim të promovimit të të drejtave të fëmijëve, komuna krijon partneritete me institucionet qendrore dhe me organizatat e shoqërisë civile, grupet e të rinjve dhe mediat.

## **Neni 17**

### **Përkrahja dhe sensibilizimi nga institucionet e komunës për të drejtat e fëmijëve**

1. Komuna ndërton partneritet me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet tjera të pavarura, me qëllim të përkrahjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve.
2. Komuna mbështet organizatat e shoqërisë civile për të zhvilluar kapacitetet e tyre në mënyrë që të ndikojnë sa më shumë në fushën e realizimit të të drejtave të fëmijëve.
3. Komuna mban komunikime të rregullta me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet tjera të pavarura në mënyrë që të sigurohet një pasqyrë reale mbi gjendjen e realizimit të të drejtave të fëmijëve.
4. Me moton "Fëmijët krenaria jonë", komuna organizon manifestim disaditor, dedikuar promovimit të të drejtave të tyre.

## **Neni 18**

### **Pjesëmarrja e fëmijëve në jetën publike**

1. Organet kompetente të komunës krijojnë hapësirë të mjaftueshme për prezencën e fëmijëve, me sa vijon:
  - 1.1 Mundësimin e themelimit të Asamblesë së fëmijëve, e cila aprovon aktet e nevojshme për funksionimin e saj;
  - 1.2. Mundësinë e pjesëmarrjes në mënyrë të organizuar të fëmijëve në aktivitete të ndryshme, të cilat realizohen nga institucionet komunale;
  - 1.3. Krijimin e mundësisë për pjesëmarrjen e fëmijëve në ambientin e punës në zyret e institucioneve komunale.

## **Neni 19**

### **Procedurat për zbatimin e kësaj rregulloreje**

1. Mekanizmi koordinues monitoron zbatimin e kësaj rregulloreje dhe harton raporte periodike për nivelin e zbatimit të saj.
2. Kuvendi i komunës shqyrton dhe miraton raportin vjetor të mekanizimit koordinues për nivelin e zbatimit të rregullores dhe në rast të moszbatimit të saj, merr vendime dhe nxjerr rekomandime për sigurimin e zbatimit të saj të plotë.
3. Kryetari i komunës brenda tre (3) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, nxjerr vendimet e nevojshme për ta implemetuar në tërësi rregulloren në fjalë.

## **Neni 20**

### **Rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve**

Në rastet kur cenohen të drejtat e fëmijëve, të garantuara dhe të mbrojtura me legjislacionin në fuqi, shkelësit e tyre do të ndëshkohen për kundërvajtje konform nenit 62 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijës.



**Neni 21**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (KKV) nr. 03/2019 për realizimin e të drejtave, mbrojtjen dhe parandalimin e punëve të rënda për fëmijë Nr. 328/19 dt: 27.11.2019.

**Neni 22**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Nasuf Aliu**

---

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

**Arsyetim**

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës, Kryetari i Komunës së Vushtrrisë formoi komisionin për harmonizimin e Rregullores aktuale me dispozitat e ligjit në fjalë. Pasi që janë bërë shumë ndërhyrje dhe ndryshim-plotësime në rregulloren aktuale, ua procedojmë për shqyrtim dhe aprovim në KPF dhe në KK si rregullore të re, e cila e shfuqizon rregulloren aktuale në fuqi.